



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-01658-11-2018	Data e Regjistrimit	7/9/2018
Numri i Vendimit	11-2018-3973	Data e Vendimit	7/31/2018

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Rexhep Bekteshi

ANËTAR

SEKRETARE Brunilda Dizdari

Objekti: 1- Heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasurinë objekt 9 kate mbi tokë dhe +1 kat nën tokë ,i ndodhur në pasurinë Nr.9/2 19, Zone Kadastrale 8518, në Lagjen Nr.13, Plazh —Dunes.
2- Vendosjen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasurine objekt 9 vetërn per katin e fundit të objektit.

Baza Ligjore : Neni 274 të K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Në gjykim mori pjesë **Prokurorja e çështjes Ornela Rrumbullaku**.<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Gjykata mori në shqyrtim çështjen dhe në seancën gjyqësore të datës 27.07.2018, avokatja mbrojtëse Mariola Çausi dhe kërkuesi ***** prezent në gjykim deklaruan se heqin dorë nga kërkesa e bërë me objekt: Heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasurinë objekt 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë i ndodhur në pasurinë Nr. 9/219, Zona Kadestrale 8518, në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës e vendosjen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasurinë objekt 9 kat, vetëm për katin e fundit të këtij objekti dhe i kërkuan Gjykatës të pushojë çështjen penale.

Prokurorja e çështjes Ornela Rrumbullaku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se është në vullnetin e kërkuesve të heqin dorë nga kërkesa e bërë nëpërmjet avokates mbrojtëse të tyre e Gjykata duhet të pushojë çështjen penale meqenëse avokatja mbrojtëse dhe kërkuesi ***** hoqën dorë nga kërkesa e bërë.

